
**AKT THEMELIMI DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“AB Elbasan” SHPK**

EMËRTIMI – SELIA – KOHËZGJATJA

NENI 1.

KRIJIMI, EMËRTIMI I SHOQËRISË.

1.1 Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “**AB Elbasan shpk**” në vijim e quajtur “**Shoqëria**” **ne daten 21.07.2021**

1.2. Shoqëria themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar identifikuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 2.

SELIA.

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Zona Kadastrale 3965, Rruga Metalurgji, pranë zyrës së Ndermarjes së Prodhimit Celiqeve, Elbasan

2.2 Me vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të hape zyra përfaqësie, degë, dhe/ose të krijojë filiale brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3.

KOHËZGJATJA.

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të papërcaktuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, duke filluar nga rregjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 4.

OBJEKTI I SHOQËRISË.

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

- Prodhim industrial, rrobaqepesi, konfeksionim veshjesh të ndryshme, tregtimi me shumice dhe pakice i artikujve të ndryshëm të konsumit të gjere industrial, veshjesh, zhvillimin e import eksporteve të mallrave të ndryshëm si industriale, materiale të ndryshme ndertimi, produkte druri dhe mobilje, makineri dhe pajisje. Fason që punon me autorizim të rregjimit të perpunimit aktiv (RPA).

4.2 Për të arritur objektin të saj, Shoqëria, me vendim të Asamblesë mund të realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja.



4.3 Shoqëria, dhe me qëllim arritjen e objektit të saj, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo ndërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprim tregtar që do ta konsiderojë të nevojshëm.

KAPITALI.
PASURIA DHE FINANCIMI I SHOQËRISË

NENI 5.
KAPITALI THEMELTAR.

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1,000 lek, i ndarë në 1 kuotë. Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 6.
ORTAKËT.

6.1 Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortaku i vetëm :

- **Agron Ballolli, shtetas shqiptar, i lindur me date 19/04/1966, në Shirgjan, identifikuar me nr. personal G60419009H, madhor e me zotesi të plote juridike për të vepruar. Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë 1,000 leke që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.**

NENI 7.
TRANSFERIMI I KUOTAVE.

7.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme pa miratim paraprak të asamblesë së ortakëve.

7.2 Transferimi i kuotave duhet të realizohet në përputhje me ligjin dhe të regjistrohet në QKB sipas parashikimeve ligjore.



NENI 8.
FINANCIMI I SHOQËRISË.

8.1. Shoqëria me qellim arritjen e objektit të saj, do të kërkojë financimin nëpërmjet mënyrave ligjore si kredi bankare, hua, financim nga ortakët dhe çdo formë tjetër ligjore.

NENI 9.
ORGANET E SHOQËRISË.

9.1 Organet e Shoqërisë janë:

- Administratori,
- Asambleja e Ortakëve.

NENI 10.
ADMINISTRATORËT
FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT.

10.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator. Administratori është i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet tregtare të shoqërisë pa kufizim kompetencash, përveç atyre që ligji, akti i themelimit dhe statutija ngarkon Asamblesë së Ortakëve.

10.2 Administratori i shoqërisë kryen administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë. Shoqëria ka si administrator **Z.Agron Ballolli, shtetas shqiptar, i lindur me date 19/04/1966, në Shirgjan, identifikuar me nr personal G60419009H, madhor e me zotesi të plote juridike për të vepruar.**

10.3 Administratori ka të gjitha kompetencat për përfaqësuar shoqërinë në marrëdhënie me të tretët. Ai vepron në emër të shoqërisë dhe nënshkruan çdo dokument të shoqërisë. Administratori nuk ushtron kompetencat që ligji ose aktet e shoqërisë ja japin shprehimisht Asamblesë së Ortakëve. Administratori emërohet për një afat 5 vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

10.4 Administratori mund të autorizoj një person të kryejë veprim në QKB si depozitim aktesh, vendimesh, bilance, statutit dhe çdo akte tjetër.

10.5. Administratori përfiton shpërblim/pagesa për punën e tyre me në



masën e përcaktuar me vendim të asamblesë së ortakëve.

10.6. Administratori ka të drejtë ti delegojë aksionerit të gjitha të drejtat sikur të ishte ai vet ne lidhje me të gjitha institucionet financiare, drejtoritë e tatimeve, bankat etj .

NENI 11.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE.

11.1. Asambleja e Ortakëve është organi me i larte i shoqërisë dhe vendos për çdo çështje qe ligji ose ky statut ia rezervon asaj. Vendimet e Asamblesë janë te detyrueshme te zbatohen nga organet e shoqërisë.

11.2. Mbledhjet e Asamblesë se Ortakëve organizohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

11.3. Asambleja zhvillohet ne mënyrë te rregullt dhe vendos ne mënyrë te rregullt sipas kuorumit te parashikuar nga ligji.

11.4. Mbledhjet e Asamblesë zhvillohen normalisht ne selinë e shoqërisë por, me vendim të sajin Asambleja mund te mblidhet edhe ne një vend tjetër brenda ose jashtë Shqipërisë.

11.5. Ortakët njoftohen për mbledhjen e asamblesë te paktën 7 dite përpara dhe duhet te marrin njoftimin per datën, orën, vendin, rendin e ditës dhe te marrin kopjen e dokumenteve që lidhen me rendin e ditës.

11.6. Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve mund të thirren nga Administratori/administratorët, ose nga subjekte të parashikuar ne ligj.

NENI 12.

VITI FINANCIAR.

12.1. Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

12.2. Bilanci i shoqërisë mbahet në përputhje me ligjin, miratimi dhe cdo veprim tjetër merret në përputhje me parashikimet ligjore.

NENI 13.



PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË.

13.1. Procedura e likuidimit e parashikuar ne ligjin nr. 9901, date 22.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" zbatohet ne rastin e prishjes se shoqërisë.

13.2. Shoqëria prishet ne rastet e mëposhtëme: me vendim të asamblesë; me hapjen e procedurave të falimentimit; me vendim gjykate; dhe për çdo arsye tjetër parashikuar në akte të shoqërisë ose në legjislacionin shqiptar.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE


NENI 14.

LIGJI I ZBATUESHËM.

14.1. Shoqëria do te kryeje veprimtarinë e saj ne përputhje me këtë statut dhe me parashikimet e ligjeve shqiptare. Për sa nuk është parashikuar ne këtë statut do te zbatohet ligji shqiptar nr. 9901, date 22.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

14.2. Ky akt themelimi dhe statut hartohet dhe nënshkruhet ne 5 kopje origjinale

Ortaku


AGRON BALLOLLI

